REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A.
DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I SHËRBIMEVE DHE MALLRAVE

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

Për: **"Kupa sh.p.k**" **sh.p.k**

Adresa: Tirane Kamez KAMEZ Rruga Berisha, Argjjinatura me nr.pasurie 482, Çerkeze.

Për:" **Alentre**"**sh.p.k**

Adresa: Durres Sukth HAMALLAJ Ndërtimi i Kompleksit Turistik New Born, Zona Kadastrale 1925, Nr.Pasurie 2/23

Për:**" Fusha**" **sh.p.k.**

Adresa: Tirane Njesia Bashkiake nr 2, Rruga Murat Toptani, perballe Kinema Milenium, godina nr.3, Pedonalja.

Për:" Sireta 2 F" **sh.p.k.**

Adresa: Tirane Paskuqan PASKUQAN Lagjia Babrru Fushe, Komuna Paskuqan

* * *

Procedura e prokurimit: "**Blerje Rërë Kuarcore**"

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF**-73411-09-29-2020
Përshkrim i shkurtër i kontratës: "**Blerje Rërë Kuarcore "**Kërkesë për Propozime Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara" me fond limit 4,996,650(katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë)lekë pa tvsh.

Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: □ oferta ekonomikisht më e favorshme □çmimi më i ulët X(Shumatorja e cmimeve për njësi)

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **“Kupa sh.p.k**” **sh.p.k** K51615512C

Totali i çmimeve për njësi 0(zero)lekë pa tvsh.

2. **“Alentre sh.p.k** ” L21905503G

Totali i çmimeve për njësi 32,500 lekë pa tvsh.

3. **“Fusha sh.p.k** ” J61922018S

Totali i çmimeve për njësi 29,890 (njëzetë e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh.

4. **“ Sireta 2 F sh.p.k** ” K51501008J

Totali i çmimeve për njësi 33.000 (tridhjetë e tre mijë) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë te mëposhtëm:

1. **“Kupa sh.p.k**” **sh.p.k** K51615512C

Totali i çmimeve për njësi 0(zero)lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomim Kupa sh.p.k me ofertë 0 (zero).
Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria **“** Kupa ” sh.p.k nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në DST.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave.

Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik **“**Kupa” sh.p.k s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, shtojca 8, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë te mëposhtëm:

2. **"Alentre sh.p.k** " L21905503G

Totali i çmimeve për njësi 32,500 lekë pa tvsh.

1.Oferta e paraqitur nga OperatorI Ekonomik " Alentre "sh.p.k me çmim për njësi 32,500 lekë pa tvsh.
Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator ekonomik , nga ku konkludon si më poshtë vijon:
Së pari AK ka kërkuar në kushtet e veçanta e kualifikimit pika 2.1 gërma dh) si më poshtë vijon:
dh.Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.
Në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST operatori ekonomik **Alentre sh.p.k** *"Vërtetim debie" nr.* **6026/1,** *prot, datë 23.07.2020 lëshuar nga FSHU në emër të kërkuesit "***Alentre sh.p.k** "*ku evidentohet që: "… nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratat me rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 23.07.2020 përfshirë faturën koherente të muajit Qershor 2020.*

Referuar Nenit 9 ("Pagesa dhe afati për kryerjen e saj"), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 "*Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë*", përcaktohet shprehimisht që: "*Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.*
Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për proçedurën e prokurimit konkretisht muajin Gusht 2020.
Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik "nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma "dh" të vendosur në DST, c'ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma "c" ku ndër të tjera citohet se "*Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.*"
Gjithashtu vlen të theksojmë se publikimi i procedurës objekt në sistemin elektronik të app-së është bërë në datën 30.09.2020 dhe referuar datës të hapjes së ofertave është lënë më datën 12.10.2020 brenda këtij afati operatorët ekonomikë e kishin detyrim të kishin bërë bërë pagesën e faturës së muajit Gusht 2020 si dhe të pajiseshin me vërtetim mbi shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori

ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri kjo theksojmë Referuar Nenit 9 ("Pagesa dhe afati për kryerjen e saj"), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 "*Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë*", përcaktohet shprehimisht që: "*Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar. N*ë mbështetje të VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma "c" ku ndër të tjera citohet se "*Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.*
Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm.
Së dyti AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon:
b. Deklarate për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 2/1;
c.Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 5/1;
ç.Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
d.Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik Alentre sh.p.k nuk ka arritur të paraqesë deklaratat e kërkuara në DST.
Në rregullat e prokurimit publik theksohet se , operatorët janë të detyruar të pergatitin ofertat dhe paraqesin të plotë të gjithë dokumentacionin e kërkuar në DT .
Moplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vetëm përbën shkak për skualifikim .
Në shtojcën 8 shprehimisht parashikohet se…. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.
Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik" (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu VII,Neni 66 pika 3, e **shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

"Fusha sh.p.k " J61922018S

Totali i çmimeve për njësi tvsh. 29,890 (njëzetë e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë) lekë pa

" Sireta 2 F sh.p.k " K51501008J

Totali i çmimeve për njësi 33.000 (tridhjetë e tre mijë) lekë pa tvsh.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë UKT sh.apranë Drejtorisë së Prokurimeve brenda 60(gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 13.10.2020
Ankesa: JO